



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	248/18
Nr. i fq. / Br. st	- 10 -
Data: / Datum	29. 12. 2016
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E X-të E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 24 NËNTOR 2016**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:09.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:
Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Finesë Cakoli, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.
Mungoi: Mirjeta Salihu.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, Nënkyetari i komunës, delegacioni nga Komuna e Växjö-s të Suedisë i kryesuar nga z. Beni Johanson kryesues i Kuvendit të Komunës Växjö të Suedisë, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesit e Komiteteve Konsultative dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – në fillim të punimeve të mbledhjes së kuvendit përshtëndeti delegacionin nga Komuna e Växjö-s të Suedisë, dhe konstatoi se në mbledhje janë prezent 30 anëtarë të kuvendit, shumicë e mjaftueshme për zhvillimin e punimeve të mbledhjes. Tutje ai në kuadër të debatit për rendin e ditës propozoi që pika e parë që do të shqyrtohet të jetë partneriteti mes Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës Växjö të Suedisë.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi i Komunës pas votimit në mënyrë unanimi aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Partneriteti mes Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës Växjö të Suedisë;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen shëndetësore të qytetarëve në Komunën e Vushtrrisë;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e ambientit;
6. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore;
7. Shqyrtimi i Informatës tremujore lidhur me punën e Zyrës Ligjore;
8. Shqyrtimi i Informatës tremujore lidhur me punën e Zyrës së Informimit;

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për autorizimin e përfaqësuesit ligjor të komunës për lidhjen e ujdisë gjyqësore;
10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me vërshimet në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
11. Të ndryshme.

1. Partneriteti mes Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës Växjö të Suedisë;

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – falënderoi përfaqësuesit e delegacionit të Komunës Växjö për bashkëpunimin e që kanë pasur që nga viti 2013, dhe ceku se si rezultat i këtyre bashkëpunameve ka filluar shkëmbim i përvojave mes Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe Kuvendit të Komunës Växjö të Suedisë si projekt i veçantë. Tutje shtoi se gjatë këtyre ditëve sa delegacioni i Komunës Växjö po qëndron në Vushtrri, si delegacione kemi pasur një agjendë mjaft të ngjeshur, por kjo ka ndikuar në mënyrë pozitive në shkëmbimin e përvojave të dy kuvendeve tona. Në fund ai falënderoi delegacionin nga Komuna Växjö dhe iu uroi qëndrim të këndshëm në komunën tonë.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës - pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit e në veçanti z. Beni Johanson – kryetar i Kuvendit të Komunës Växjö, tha se Komuna e Vushtrrisë dhe Komuna Växjö e Suedisë me ndërmjetësimin e z. Islam Islami, bashkëvendas i yni me banim në Växjö, me propozim të dy qeverive dhe vendim të dy vendeve nënshkruan Marrëveshjen për partneritet dhe bashkëpunim reciprok më 2013.

Växjö është një komunë me 88.000 banorë me 3.000 shqiptarë të Kosovës dhe 20% të kësaj popullata të vendeve të ndryshme të botës, të gjithë të integruar mirë në këtë komunë; Me një përvojë të qeverisjes afatgjate demokratike lokale:

Një qytet universitar; me zhvillim të fortë ekonomik; me arsim të avancuar; shëndetësi dhe shërbime shëndetësore bashkëkohore; me përvojë në menaxhim dhe ofrim të shërbimeve për qytetarët në administratën komunale; me legjislacion të avancuar dhe bashkëkohor të kuvendit dhe qeverisë komunale; me nivel të lartë te menaxhimit të ambientit dhe me epitetin "Qyteti më i gjelbërt në Evropë". Për komunën tonë ishte një çast ideal po edhe privilegji, që në kuadër të këtij partneriteti, të mbështetemi pa kursim për ngritjen e kapaciteteve menaxhuese në të gjitha fushat e qeverisjes lokale. Komuna Växjö, në kuadër të implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit deritani, do të organizojë vizita për 8 grupe të Komunës së Vushtrrisë në Komunën e Växjö-s dhe 8 grupe punuese të komunës së Växjö-s në Komunën e Vushtrrisë, me të gjitha shpenzimet e tyre e që e arrijnë vlerën e 560.000€.

Në këtë rast të gjithë zyrtarët e Qeverisë të Komunës së Vushtrrisë, pedagogë, pjesëtarë të tjera të organizatave, bizneseve, atyre joqeveritare, patën rastin që të njihen për së afërmë nëpërmes sqarimeve teorike nga përfaqësues të grupeve profesionale të Växjö-s dhe vizitatave konkrete, me të gjitha të arriturat e Komunës së Växjö-s, në fushat për të cilat kishin shkuar në vizitë. Vizitat e grupeve të Växjö-s në Vushtrri dhe njoftimi i tyre për fushat përkatëse të interest të vizitës, si dhe këshillat e tyre për menaxhim ndryshe dhe më të avancuar e bashkëkohor demokratik ishin shumë me vlerë për neve, për të ngritë kapacitet në qeverisje në të gjitha fushat. Në fund ai shfrytëzoi rastin që ti falënderon : Kryetarin e kryesisë së Komunës Växjö-s; Z. Bu Frank, për mbështetje të gjithanshme për të realizuar çdo projekt të secilit grup, në kuadër të marrëveshjes, z. Beni Johanson – kryetar dhe znj. Mari Luis, zv.kryetare e Kuvendit të Växjö-s, për mbështetje në marrjen e vendimeve për implementim të projekteve të marrëveshjes, të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe anëtarëve të grupeve punuese të Växjö-s, për angazhim të jashtëzakonshëm në punën me grupet e Komunës së Vushtrrisë, për të demonstruar përvojat e tyre dhe në dhënie të këshillave dhe sugjerimeve, të gjithë anëtarëve të grupeve punuese të Komunës së Vushtrrisë për angazhimin në përvetësimin dhe implementimin e përvojave të marra për interesin e qeverisjes në komunën tonë në fushat në të cilat kanë punuar. Dhe krejt në fund një falënderim të veçantë i bëri z. Islam Islamit,

bashkëatdhetarit tonë që jeton e punon në Växjö, që ndërmjetësoi dhe punoi me aq ngulm e zell në këtë partneritet dhe punën e të gjitha grupeve.

Beni Johanson, kryetar i Kuvendit të Komunës Växjö - pasi përshëndeti të pranishmit, paraqiti informacione për Komunën e Växjö-s, duke njofuar se kjo komunë ka më tepër se 88.000 banorë. Tujë shtoi se ai beson se ky projekt do të vazhdojë. Pastaj shtoi se deri më tanë ata janë të kënaqur pavarësisht sfidave të reja që do të paraqiten p.sh integrimi, shkurtimi i banimit, si dhe papunësia. Ai vlerësoi se puna e tyre në mbrojtjen e ambientit ka pasur një prioritet të lartë në vitet e mëhershme dhe pikërisht për këtë Komuna e Växjö-s, ka marrë epitetin si komuna më e "Gjelbërt në Evropë", këtë epitet ia kishte dhënë BBC në vitin 2007. Pastaj fusha e arsimit është mjaft e zhvilluar në të gjitha nivelet, dhe në të gjitha sektorët arsimi ka një prioritet të lartë. Lidhur me bashkëpunimin e dy kuvendeve ceku se qëllimi i këtij projekti është që Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë dhe Kuvendi i Komunës së Växjö-s të punojnë së bashku në kuptimin e ngritjes së kompetencave për politikanët dhe stafin tjetër lidhur me punën e kuvendit komunal. Në këtë kontekst ai vlerësoi se i kanë identifikuar pesë (5) sektorë në të cilët duhet punuar së bashku së pari administrimi në takime, së dyti si të udhëhiqet puna e kuvendit në mënyrë demokratike dhe efektive, pastaj sektori i tretë i identifikuar që duhet punuar së bashku është se si të merren vendimet në organet më të larta, prioriteti tjetër është se si të rritet transparenca në të hyrat komunale, si dhe prioriteti i pestë është komunikimi me qytetarët tanë. Në vazhdim ai ceku se ka një besim të fortë në këtë projekt në bashkëpunimin që të gjenden zgjidhjet më të mira në faktet e rëndësishme dhe kjo gjithsesi se do të na ndihmojë në shkëmbimin e njoħurive dhe përvojave tona në gjitha fushat e rëndësishme. Në relacion të bashkëpunimit ai ceku se beson se të dy palët do të mund të përfitojnë nga njëra tjetra në saje të këtij projekti. Pastaj ai ceku se gjatë këtyre ditëve të qëndrimit në Komunën e Vushtrrisë si delegacion i kanë identifikuar format dhe dallimet e funksionimit të dy kuvendeve tona. Mandej ai vlerësoi se është shumë me interes që të punohet së bashku për të arritur qëllimin që ia kemi shtruar vetes. Tujë shtoi se gjatë këtyre ditëve sa delegacioni ka qëndruar në Komunën e Vushtrrisë delegacioni i Komunës së Växjö-s ka qenë shumë i mirëpritur dhe i përkujdesur nga delegacioni nikoqir. Në këtë kontekst vlerësoi se pritja dhe konsiderata kanë qenë të përkryera. Në veçanti ka qenë me interes dhe e rëndësishme të shikohet forma e mbajtes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë. Fillimi i këtij projekti ka një nismë të mirë dhe pikërisht për këtë ai i ofroi një dhuratë Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë.

Bajram Mulaku, Kryetar i komunës - i dhuroi z. Beni Johanson, kryetar i Kuvendit të Komunës Växjö-s emblemën e Komunës së Vushtrrisë.

Arta Haxhaj, drejtoreshë e DEBPZHR - paraqiti para të pranishmëve një rezyme të përgjithshme të projektit të bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Växjö-s, projekt i cili ka filluar që nga viti 2013. Gjithashtu ajo prezantoi edhe projektet të cilat janë zhvilluar më herët dhe ato që tani janë duke u zhvilluar, si dhe paraqiti të dhëna për këto projekte.

Në vazhdim të punimeve, mbledhjen e udhëhoqi anëtarë më i vjetër i kuvendit z. Muharrem Shabani.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen shëndetësore të qytetarëve në Komunën e Vushtrrisë;

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – duke iu referuar informatës në fjalë ceku se tabela krahasimore e raportimit për vitet 2015/2016, konkretisht tek pika 9 e kësaj tabelle, vlerësoi se është lajm i mirë që dyshimi për parotit epidemik numri i këtyre rasteve ka rënë nga 416 raste sa ishin në vitin 2015 këtë vit kemi vetëm 10 raste. Gjithashtu edhe rastet me tularemi nga 200 raste këtë vit nuk kemi asnjë rast, kurse çështje e cila duhet të na shqetësojë janë rastet e reja me TBC ku nga 17 rastet sa ishin në vitin 2015 këtë vit janë evidentuar 28 raste. Në këtë kontekst pyeti drejtorinë se cilat masa i ka ndërmarrë për parandalimin e kësaj sëmundjeje tek të rintjtë, por edhe cilat masa po i ndërmerr drejtoria për informimin e qytetarëve për këtë sëmundje.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – tha se pasi në rend të ditës hyri si pikë partneriteti mes Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës Växjö-s, atëherë kryesuesi i kuvendit është dashur që t'ju jep fjalën edhe anëtarëve tjerë të kuvendit që të diskutojnë. Tutje duke iu referuar faqes 3 të informatës ceku se tek shërbimi emergjent i cili vepron në kuadër të QKMF-së në bashkëpunim me spitalin “Sheykh Zaid” dhe se stafi i QKMF-së vepron në objektin e spitalit për shkak të mungesës së stafit nga ana e spitalit. Lidhur me këtë pyeti drejtorinë, se a është ky veprim në kundërshtim me ligjin dhe a është ky staf i kualifikuar, i cili vepron dhe jep shërbime emergjente sepse mjeku specialist i cili duhet të jetë në emergjencë është ai i cili ka kryer specializim nga mjekësia emergjente dhe i testuar nga një komision përkatës. Gjithashtu edhe infermieri duhet të ketë certifikim për shërbim emergjent, kjo për faktin se kemi mjaft ankesa nga qytetarët me të cilët ajo ka hasur në bashkëbisedim, e të cilët vlerësojnë se shërbimi është mjaft i dobët dhe se për një komplikim krejt të vogël ata drejtohen në QKUK në Prishtinë, si dhe ndodh që edhe mjekët nuk ndodhen në vendin e punës. Në këtë relacion ajo dëshiron të informohet nga drejtoria kompetente se kjo a është nga neglizhanca e punës apo është për shkak të shkollimit joadekuat. Pastaj ajo kërkoi të informohet që tek shërbimi radiologjik sa punëtorë janë a jepen shërbime në ndërrimin e tretë në mënyrë që t'u ofrohen shërbime edhe rasteve urgjente, të cilat drejtohen në Prishtinë vetë për shkak të një shërbimi radiologjik. Tutje në faqe numër 4 tek vizitat sistematike nëpër shkolla mendon se është dashur që të ceket se për cilat probleme janë bërë këto vizita dhe se a kishte qenë e mundur që këtyre vizitave t'u shtohet edhe një fizioterapeut për shkak se është një ndër vizitat kryesore tek fëmijët ku do të konstatoheshin deformitetet që po shfaqen sidomos në shtyllën kurrizore. Në këtë rrafsh propozoi që të hartohet një plan nga ana e drejtorisë dhe të merret edhe një fiziater që të bëjë këtë vizitë rutinore. Në fund tha se në vitin 2008 është bërë përrumi i një ambulance të vogël në fshatin Skromë, andaj për këtë pyeti kjo qendër a është funksionale, përfaktin se në kuadër të PZHK-së janë 16 objekte shëndetësore në zonat rurale të komunës dhe që parashihet të ndërtohen ende, andaj propozoi që drejtoria të hartojë një plan përfunksionalizimin e këtyre objekteve dhe pastaj të mendohet për ndërtimin e objekteve shëndetësore nëpër fshatra.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – pyeti se punktet shëndetësore apo ambulancat nëpër fshatra si punojnë, pse këto ambulanca nuk kanë mjekë të përhershëm por mjeku punon vetëm ditëve të caktuara. Pastaj pyeti se sa mjekë janë në specializim e të cilët janë duke u paguar nga buxheti komunal, si dhe ku dhe kur ata punojnë përfaktin se ata krahas specializimit marrin edhe pagën gjegjësisht numërohen se janë të punësuar në institucionë. Në këtë kontekst ai kërkoi raport me shkrim për secilin “punkt shëndetësor” jashtë qytetit, si dhe të paraqitet secili mjek me emër dhe mbiemër të cilët punojnë në këto punkte shëndetësore, ditët në të cilat ata punojnë, si dhe orarin e punës. Pastaj kërkoi të informohet përfaktë gjithë specializantët (të paraqiten me emër dhe mbiemër), të cilët krahas specializimit marrin edhe pagën nga Komuna e Vushtrrisë, në cilat ditë punojnë, ku punojnë dhe orari i tyre i punës. Kjo duhet të dihet përfaktin se kemi një neglizhencë të madhe në kryerjen e punëve, si dhe kemi mungesë të jashtëzakonshme të mjekëve, si dhe mungesë të ofrimit të shërbimeve shëndetësore përfytet. Mungesa e ofrimit të këtyre shërbimeve shëndetësore është si rezultat i asaj se shumë mjekë të cilët janë në specializim i marrin pagat e tyre, kurse arsyetohen se punojnë në ambulanca shëndetësore nëpër fshatra, ndërsa ata në fakt nuk shkojnë fare në punë. Mandej ai ceku se në tabelën e shpalljeve

duhet të figurojë se cilët mjekë punojnë në secilin punkt shëndetësor se dhe orarin e punës së tyre, kjo do të ndihmonte në informimin e qytetarëve dhe rritjen e transparencës. Në fund tha se drejtoria i ka caktuar mjekët në punktet shëndetësore, mirëpo në këtë drejtim nuk kemi një menaxhim të mirëfilltë për faktin se këta punëtorë shëndetësor nuk janë të rregullt në vijim në detyrë dhe kështu kemi mungesë të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për qytetarët tanë.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – tha se kjo informatë është mjaft e kompletuar për dallim prej informatave tjera të cilat procedohen për kuvend e të cilat nuk i përmblushin standartet e informatës. Tujë shtoi se kjo informatë është e plotësuar si me të dhëna tabelore ashtu edhe me të dhëna tekstuale. Në relacion të problemeve shëndetësore të popullatës sonë, është shqetësues fakti se kemi numër të madh të pacientëve ku për periudhën janar-tetor kanë kërkuar shërbime shëndetësore 165.744 pacientë, dhe kjo na sjellë para një përfundimi mjaft shqetësues se kemi një “popullatë të sëmure”. Dhe kjo shprehur në shifra i bie që çdo qytetar i komunës sonë brenda kësaj periudhe ka kërkuar rrëth tre (3) herë shërbime shëndetësore, kurse kur kësaj ia shtojmë edhe atë se brenda kësaj periudhe janë ofruar gjithsej 267,578.00 shërbime tjera shëndetësore, atëherë del në sipërfaqe përfundimi se çdo banor yni ka kërkuar katër (4) shërbime shëndetësore brenda periudhës nëntëmuajore dhe kjo gjithsesi se është mjaft brengosëse. Sa i përket vërejtjeve ai përsëriti, si edhe në të kaluarën se pneumonia nuk është sëmundje ngjitëse dhe kjo nuk është dashur të radhitet në këtë rubrikë. Po ashtu intoxicatio alimentaris gjithashtu nuk është sëmundje ngjitëse (por është helmim nga ushqimi). Gjithashtu sa i përket sëmundjes së hepatit kronik B, C dhe E ku janë identifikuar 4 pacientë me këtë sëmundje, për këtë vlerësoi se është dashur të ceket se kjo sëmundje (hepatit C) është mjaft e rrezikshme dhe komuna jonë më së shumti është e prekur nga kjo sëmundje në Republikën e Kosovës. Arsyet e kësaj duhet të kërkohen tek stomatologët dhe berberët për faktin se kjo sëmundje bartet përmes gjakut. Kur bëhet fjalë për tabelën krahasuese 2015/2016, atëherë duhet të jemi të kënaqur se këtë vit nuk kemi një vit endemik sikurse ishte viti i kaluar ku kishim raste të shprehura të parotitit dhe tularemisë. Lidhur me vërejtjen për mungesë të mjekëve në vend të punës ceku se duhet të specifikohet se për cilët mjekë bëhet fjalë dhe jo të përgjithësohen gjërat dhe të tentohet të komprometohen të gjithë mjekët.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – kërkoi nga kryetari i komunës, por edhe nga drejtori i DSHPS-së që aparatura mjekësore e cila ishte më herët në spitalin “Sheykh Zaid” të bartet nëpër punktet shëndetësore në zonat rurale me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më të mira shëndetësore nëpër këto qendra. Tujë duke iu referuar një emisioni televiziv ceku se zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë ishin deklaruar se iu kishte imponuar që të investojnë në Spitalin e Vushtrrisë, dhe ceku se kjo na bën të kuptojmë se kjo ministri nuk ka vullnet të investojë “as edhe një cent” në spitalin tonë. Mandej ajo është duke neglizhuar edhe me rekrutim të punëtorëve shëndetësorë dhe kjo përbëhet jo për faktin e mungesës së mjeteve financiare sepse në komunat tjera janë bërë rekrutime të stafit shëndetësor. Për këtë ceku se është mirë që të bëhen ankesa në këtë ministri.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – tha se pajtohet me konstatimin se kjo informatë është mjaft e kompletuar dhe pyeti se në bazë të konkursit që është shpallur më herët janë pranuar disa punëtorë shëndetësorë, mirëpo e keqja është se këta punëtorë që disa muaj nuk kanë marrë pagë edhe përkundër faktit se këta punojnë vazhdimi, andaj për këtë pyeti pse këta punëtorë nuk kanë marrë pagë, si dhe kur do të hyjnë në lisën e pagave. Pastaj pyeti se disa vende të cilat janë të lira në stafin shëndetësor pas pensionimit të disa punëtorëve shëndetësorë, ku në këtë rast pagat e tyre janë të planifikuar dhe me këtë rrezikohet që këto mjete të shkojnë në suficit, kurse njerëzit që kanë përgatitje profesionale janë të papunë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se në bazë të kësaj informate ne veç i kemi të identikuara problemet, mirëpo tanë mbetet që të ndërmerrën masat për përmirësimin e gjendjes. Sa i përket sëmundjeve infektive është shqetësuese sidomos rritja e të prekurve me TBC-së, në këtë kontekst kemi neglizhencë për faktin se është menduar që kjo sëmundje është eliminuar, por fatkeqësish po del se për çdo vit kemi rritje të numrit të të prekurve me këtë

sëmundje ku në vitin 2015 kemi pasur 17 raste dhe në këtë vit numri është rritur në 28 të prekur. Pastaj sa i përket hepatit B dhe C, i cili bartet përmes gjakut, mund të thuhet se raportimi nuk është i saktë dhe kishte me qenë mirë që të kërkohet me shkrim nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, por edhe nga Klinika Infektive që të dihet se sa është numri i këtyre të prekurve, por edhe të konstatohet burimi i infektimit sepse ata të prekur e dinë saktësish se prej cilave ordinanca kanë marrë shërbime shëndetësore së fundmi dhe në këtë kontekst duhet të ndërmerrën masat. Lidhur me këtë problematikë ai vlerësoi se nuk mjafton që këto defekte vetëm të konstatohen, por të gjenden edhe zgjidhjet dhe për këtë propozoi që komuna gjegjësisht Drejtoria e Shëndetësisë të kërkojë nga ministria e linjës që të bëjë rritjen e numrit të inspektorëve shëndetësorë, të cilët janë kompetentë që të monitorojnë punën e institucioneve publike shëndetësore por edhe atyre private shëndetësore. Kur bëhet fjalë për punën e punkteve të mjekësisë, ai ceku se është në dijeni se ato funksionojnë, kurse bazuar në ligj mjekët nuk është e obliguar që të vijojnë në punë çdo ditë por ata duhet të janë në punë dy apo tri herë në javë. Në vazhdim ai vlerësoi se ne akoma nuk kemi arritur që të zbatojmë konceptin e mjekësisë familjare që lidhet edhe me zonimin e pacientëve dhe këto gjëra janë në rrugë e sipër dhe për këtë duhet të angazhohemi. Sa i përket perfeksionimit profesional (specializimit) ka njerëz që janë duke specializuar dhe ata janë vullnetarë sepse komuna gjegjësisht Drejtoria e Shëndetësisë nuk është ajo që ndan specializime kurse, ata orarin e punës e mbajnë rregullisht, andaj për këtë për ngritje profesionale këta mjekë nuk duhet të pengohen por duhet të mbështeten. Në fund tha se në saje të vizitave sistematike shëndetësore nëpër shkolla bëhet identifikimi i problemeve, ku janë të angazhuar specialistë të mjekësisë familjare, stomatologu me stafin përcjellës dhe nëse haset në patologji këta nxënës referohen qoftë tek fiziatri qoftë tek ortopedi.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së - duke referuar lidhur me informatën në fjalë, dha përgjigje në pyetjet e parashtruara nga anëtarët e kuvendit. Në pyetjen lidhur me pagesën e tre punëtorëve shëndetësorë u përgjigj se ka pasur mjaft probleme lidhur me pagesat e tyre dhe për këtë fajtore është Ministria e Financave për arsyen se në bazë të një rregulloreje të aprovuar nga kjo ministri ka qenë obligim që para se të shpallet konkursi të merret pëlqimi i kësaj të fundit, por në saj të angazhimit të drejtorisë dhe të vetë kryetarit të komunës kjo problematikë është zgjidhur dhe këta mjekë janë futur në sistemin e listave të pagave. Lidhur me atë se përsë nuk po shpallet konkursi për vende të reja pune në sektorin shëndetësor është pikërisht fakti i mosaproimit të pagave nga Ministria e Financave. Pastaj ai njoftoi se brenda një kohe të shkurtër Këshilli i Drejtues i Qendrës Kryesore i Mjekësisë Familjare do të marrë vendim që të bëjë kërkesë tek Ministria e Financave që të lejohet shpallja e konkursit për këto vende të lira të punës, në pajtueshmëri me pagat që janë të lira. Lidhur me sensibilizimin për sëmundjen e TBC-së njoftoi se kjo çështje është program i Ministrisë së Shëndetësisë por drejtoria do të bëjë përpjekje për sensibilizimin e kësaj problematike. Funksionimi i punkteve shëndetësore është evident me faktin se janë realizuar gjithsej 165.000 .00 vizita shëndetësore brenda vitit dhe nëse nuk do të punojnë këta mjekë këto vizita nuk do të mund të realizoheshin. Mandej lidhur me ankesat nga ana e pacientëve njoftoi se për këtë janë ndërmarrë masa adekuate për adresimin e këtyre shqetësimeve. Lidhur me çështjen e specializantëve njoftoi se janë disa mjekë të cilët janë duke specializuar në Universitetin e Prishtinës dhe kjo është punë e interesit komunal që të mbështet këta mjekë, përfaktin se spitalit dhe komunës sonë i nevojiten specialistë, por këta mjekë edhe përkundër specializimit ata i mbajnë nga 48 orë në orar të punës. Sa i përket pajisjeve të "vjetra" të cilat kanë qenë në spitalin tonë ato tani gjenden në një depo në Mitrovicë dhe drejtoria ka bërë kërkesë në Shërbimin Spitalor Klinik për kthimin e atyre pajisjeve dhe tani ne presim që ato pajisje të na kthehen për nevojat tona. Në fund vlerësoi se shërbimi emergjent është problem që është duke e përcjellë komunën tonë që disa vite dhe kuvendi në këtë rast ka marrë një vendim që e autorizon kryetarin e komunës që të nënshkruajë një marrëveshje bashkëpunimi me spitalin. Kjo marrëveshje është nënshkruar kurse Ministria e Shëndetësisë ka konstatuar se ajo marrëveshje nuk është në pajtim me ligjin.

4.Shqyrtimi i Informatës lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve dhe zhvillimin e bizneseve;

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se ajo çka është e rëndësishme është fakti se po subvencionohen bizneset e vogla, mirëpo kur diçka punohet atëherë ato gjëra duhet të jenë të matshme dhe të përmbushin pritet e caktuara. Kur bëhet fjalë për subvencionimin e fermerëve atëherë duhet ditur se sa fermerë kemi në komunë tonë dhe cilët janë subvencionuar, me çka janë subvencionuar ata fermerë dhe cilat lloje të bizneseve. Në këtë relacion kur aplikojmë subvencione ndaj një subjekti duhet kontrollohet efekti praktik i ngritjes së shkallës sociale, por edhe efekti ekonomik i ndikimit të shtimit ekonomik dhe kjo do të mund të arrihet përmes kontrollit praktik në terren nga ana e autoriteteve komunale, duke përfshirë këtu indikatorët ekonomikë se sa persona janë punësuar dhe vetëpunësuar, si dhe ndikimi në përmirësimin e gjendjes sociale i personave që përfitojnë subvencione nga komuna.

5.Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e ambientit;

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit – tha se ndërtimi i kanalizimeve ka efekt pozitiv në parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në ambient të hapur por edhe në lumenj. Projektet e tillë të kanalizimit në disa fshatra janë realizuar pothuajse në tërësi dhe të njëjtat kanë gjatësi me kilometra. Tutje shtoi se në fshatin Ashlan në një lagje të caktuar kanalizimi derdhet në ambient të hapur dhe në lumë (prrockë) me çka në këtë formë këto ujëra bëhen pengesë për shtëpitë tjera që gjenden afër. Në këtë kontekst ajo shtoi se heqja e ujërave të zeza nga një lagje dhe derdhja e tyre në lagje tjetër nuk beson se është zgjidhje dhe kjo paraqet rrezik për qytetarët e atyre lagjeve e veçanërisht përfshirë. Në fund ajo pyeti drejtorin se a do të bëhet rregullimi i atij kanalizimi në fshatin Ashlan.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se kur bëhet fjalë për ofrimin e informatave para anëtarëve të kuvendit, është mirë që gjérat në këto informata të precizohen dhe jo të ofron informata vetëm sa për ta përbushur një obligim. *Duke iu referuar informatës citoi: gjatë vizitave nëpër fshatra, hasim në deponi të ndryshime të mbeturinave dhe ato drejtoria i largon, kurse kjo ka ndikim dhe rezultat pozitiv për qytetarët, në ç'rast bëhet përmirësimi në mbrojtjen e mjedisit*". Në këtë kontekst ai vlerësoi se duhet të precizohet se në cilat fshatra është bërë largimi i atyre deponimeve ilegale, përfaktin se të gjithë e shohin se këto deponi janë prezent gjithandjej nëpër fshatrat e komunës. Pastaj lidhur me vendosjen e kontejnerëve paraqiti vërejte përfaktin se ata janë vendosur në vend joadekuat (në udhëkryqe) dhe kështu po rrezikohet komunikacioni dhe udhëtarët. Mandjej thuhet se është bërë dezinfektimi, dezisektimi dhe deratizimi, por nuk ceket se në cilat vende andaj kërkoi që këto gjëra të precizohen. Në fund tha se është mirë që buka me të cilën furnizohen nga furrat e ndryshme të shërbehet me qese najloni me qëllim të shhangies se papastërtive të ndryshme, dhe vlerësoi se drejtoria por edhe kuvendi duhet të sillen me shumë përgjegjësi përfaktin se ata janë zyrtarë që kanë për obligim të punojnë përi interesin publik.

6.Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore;

7.Shqyrtimi i Informatës tremujore lidhur me punën e Zyrës Ligjore;

8.Shqyrtimi i Informatës tremujore lidhur me punën e Zyrës së Informimit;

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – kërkoi nga Zyra e Informimit që të gjitha konkursat, por edhe njofimet për tubime publike të shpallen në faqen e facebook-t, në këtë kontekst kërkoi që të gjitha këto publikime të bëhen të sponsorizuara përi territor të Komunës së Vushtrrisë ku kjo

do të mundëson me që çdo qytetari të Vushtrrisë do t'i postoheshin në profilin e tij të facebook-t, lajmet nga komuna.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për autorizimin e përfaqësuesit ligjor të komunës për lidhjen e ujdisë gjyqësore;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës – Komunës së Vushtrrisë z. Idriz Muzaqi, autorizohet që të arrijë pajtim gjyqësor me përfaqësuesin e autorizuar të paditëses avokat Nexhat Beqiri lidhur me lëndën C.nr. 6/15, që në emër të:

1.1 Kompensimit të dëmit për rrënimin e shtëpisë të paditësit, në sipërfaqe prej 38.07 m^2 t'i kompensohet shuma prej 7,000.00 €;

1.2 në emër të shpronësimit të parcelës kadastrale nr.516-1 në sipërfaqe prej 40 m^2 t'i kompensohet shuma prej 520.00 € (ashtu si e ka vlerësuar Departamenti i Tatimit në Pronë), dhe

1.3 në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore, shumën prej 624.60 €, ku përfshihen:

1.3.1 Për padi: 104 €;

1.3.2 për taksë gjyqësore: 15 €;

1.3.3 për pjesëmarrje në tri seanca gjyqësore: 405.60 €, dhe

1.3.4 për ekspertizë: 100 €;

1.4 totali i shumës e cila duhet t'i kompensohet paditëses është: 8,144.60 €.

2. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që ta bëjnë ekzekutimin e pajtimit gjyqësor.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryetari i Komunës dhe Zyra Ligjore.

10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me vërvshimet në territorin e Komunës së Vushtrrisë;

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit – tha se viteve të fundit vërvshimet në komunën tonë janë të shpeshta dhe këto vërvshime po i prekin sidomos kulturat bujqësore, ku mund të thuhet se ndër fshatrat më të prekura janë: Dobërrluka, Pestova, Nedakoci por edhe fshatra tjera. Komuna ka caktuar një komision për vlerësimin e dëmeve por këto vlerësimë janë bërë edhe viteve të kaluara dhe asnjëherë nuk është bërë kompensimi i këtyre dëmeve, as nga komuna e as nga niveli qendror. Tëtje ai propozoi që viteve të ardhshme të jetë si prioritet projekti për mbrojtjen e bujqve nga dëmet nga fatkeqësítë natyrore por të bëhet edhe kompensimi i tyre në rast të dëmeve. Pastaj ai vlerësoi se në rastet e subvencionimit nga ana e komunës prioritet të kenë këta fermerë të dëmtuar, dhe jo që subvencionet të ndahen për militantë partiak siç ishte rasti me ndarjen e mjedrave.

Arta Ismajli, anëtar e kuvendit – duke iu referuar informatës në fjalë, ku ndër të tjera thuhet se: Pas fillimit të përkeqësimit të situatës atmosferike në shumë fshatra, atëherë komuna ishte e detyruar që të angazhojë edhe kompaninë e kontraktuar për rrënim të objekteve të ndërtuara pa leje, në mënyrë që t’ju përgjigjeshim kërkeseve të qytetarëve, në këtë kontekst ajo pyeti se përcilat rrënime të ndërtimeve pa leje e ka pasur “fjalën drejtoria”. Mandej duke parë që tashmë disa fshatra po ballafaqohen me situatë të rëndë, në rastet kur kemi reshje të vazhdueshme atmosferike, andaj në këtë rrafsh ajo pyeti se drejtoria kompetente a ka ndonjë plan përmenaxhimin e këtyre situatave siç është p.sh evakuimi i qytetarëve. Gjithashtu pyeti se a ekziston ndonjë plan nga komuna gjegjësisht drejtoria, përkompensimin e dëmeve në rastet e fatkeqësive natyrore.

Zoran Rakiç, anëtar i kuvendit – tha se gjatë këtyre vërvshimeve në territorin e Komunës së Vushtrisë është prekur edhe fshati Prelluzhë ku janë vërvshuar 191 shtëpi. Andaj në këtë rast përmes Zyrës për Komunitete kemi kërkuar ndihmë, komuna ka dërguar mjete për pastrimin e kanaleve. Gjatë atyre ditëve të reshjeve, fshatin e Prelluzhës e ka vizituar drejtori i Drejtorisë për Emergjencë dhe komuna ka bërë atë çfarë ka qenë e mundur. Afro 20 familje rome janë shpërndaritur nga shtëpitë dhe janë vendosur në shkollë, këtyre familjeve iu ka ofruar ndihmë Kryqi i kuq. Ajo çka është e rëndësishme që komuna të bëjë në të ardhmen që të pengohet vërvshimi i shtëpive është që kompania kontraktuese së bashku me hekurudhën të bëjnë pastrimin e kanaleve që gjinden nën hekurudhë, kanale të cilat shërbejnë përrnjedhën e ujërave. Këtë kërkese ai njoftoi se e kanë adresuar edhe nga Komiteti për Komunitete tek kryetari i komunës. Në fund ai pyeti se përsë akoma nuk ka dalë në terren komisioni përvlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërvshimet.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se kjo informatë është dashur të jetë më e detajuar, duke u plotësuar edhe me të dhëna tjera lidhur me lagjet që kanë qenë më të prekura nga vërvshimet, si dhe numri i shtëpive që janë vërvshuar. Pastaj ai vlerësoi se duhet të hyjë në prioritet rregullimi i shtratit të lumit “Podranqa”, sepse gjatë reshjeve të vazhdueshme ai del nga shtrati dhe vërvhon shumë sipërfaqe dhe shtëpi ku edhe shkaktohen dëme të konsiderueshme.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – tha se disa fshatra të rajonit të Çiqavicës po kanë mjaft vështirësi në kohën e reshjeve të vazhdueshme, përfaktin se rruga tek ura e lumit “Silnica” po dëmtohet dhe të njëjtën po jemi të detyruar ta hapin me qëllim të shëmangjes së vërvshimeve. Andaj lidhur me këtë problematikë ai propozoi që të bëhet zgjidhja me aneks të urës ku do të mundësohej depërtimi më i lehtë i ujit dhe rruga nuk do të dëmtohet.

Nezir Klinaku, drejtor i DMSH-ës - paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit, ku ceku se në informatë janë prezantuar të dhënat përfaktore që gjitha fshatrat e përfshira me vërvshime. Tutje shtoi se më i prekur nga vërvshimet ka qenë fshati Prelluzhë, ku ka pasur edhe probleme tjera të natyrave të ndryshme. Sa i përket fshatrave tjera mund të përmendim Pestovën ku kanë qenë katër shtëpi të vërvshuara, në fshatin Nedakoc ka qenë e vërvshuar një (1) shtëpi. Pastaj njoftoi se drejtoria ka vënë në dispozicion gjitha kapacitetet e saj, si dhe ka kërkuar ndihmë nga AME-ja ku ata na janë përgjigjur me qëllim që t’ju dalim në ndihmë qytetarëve të komunës sonë. Në vazhdim ai vlerësoi se prioritet i komunës ka qenë mbrojtja e jetës së qytetarëve ku kjo është arritur, kurse sa i përket dëmtimit të pronës ai ceku se kryetari i komunës ka formuar një komision përvlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërvshimet, dhe këto vlerësimet do të bëhen shumë shpejt. Gjatë kohës sa ka zgjatur kjo gjendje ai theksoi se janë ballafaquar me disa probleme, ku disa qytetarë të komunitetit serb në fshatin e Prelluzhë kanë refuzuar t’ju ofrohet ndihma nga institucionet e Republikës së Kosovës, dhe ndihmën e kanë kërkuar nga institucionet e Republikës së Serbisë, por ata nuk iu janë përgjigjur. Mandej kur bëhet fjalë për rrugën tek ura e lumit Silncë në fshatin Gllavatin është e vërtetë që kur ka reshje të mëdha atmosferike gypi i vendosur afër urës nuk e bart ujin dhe jemi të detyruar ta bëjmë hapjen e rrugës, dhe kjo gjendje është rezultat i faktit se ura e ndërtuar para disa viteve është lënë e shkurtër. Si zgjidhje përkëtë problematikë ceku se duhet të ndahen mjete përrregullimin e kësaj pjese të rrugës.

11.Të ndryshme.

Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – ngriti si shqetësim problemin me qentë endacakë, ku edhe përkundër faktit se komuna ka shpallur tender për këtë, por asnjë operator ekonomik nuk ka konkurruar për ofrimin e këtyre shërbimeve. Tuje shtoi se tani pasi të ftohet koha ata paraqesin rrezik sidomos për fëmijët. Oferta e shpallur nga komuna ka qenë e ulët në kuptimin financierandaj propozoi që këto mjete të rriten për faktin se kjo çështje është mjaft serioze, sepse qentë endacakë paraqesin jo vetëm rrezik fizik por ndikojnë edhe në përhapjen e sëmundjeve infektive. Në fund i propozoi kuvendit që të rritet vija buxhetore edhe për 10.000 € për trajtimin e kësaj problematike.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit – pyeti Drejtorinë e Arsimit se shkolla e re e përfunduar në fshatin Maxhunaj, ku tani është bërë përrurimi i saj dhe në media ishte shfaqur që dy ballkona të kësaj shkolle ishin ndërtuar jashtë projekti të ndërtimit të kësaj shkolle.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – pyeti se më datën 16.11.2016 në shkollën SHMU-1- është punësuar një punëtor i arsimit, andaj lidhur me këtë çështje kërkoi të informohet me shkrim nga Drejtoria e Arsimit.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit – pyeti se përsë nuk po procedohet në kuvend Plani Zhvillimor Komunal, dhe se cila është arsyja e vërtetë që tash e tre muaj ky dokument është stopuar dhe ceku se a mos koalicioni qeverisës në Komunën e Vushtrrisë po e pengon aprovimin e këtij plani.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – ngriti shqetësimin e tij se në gjimnazin e qytetit është punësuar një punëtor i arsimit dhe ka informacione se ai nuk iu ka nënshtruar procedurave të konkursit.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit – tha se qe një kohë të gjatë disa rrugë (ASFALTET) janë “prerë” që të rregullohen dhe ato akoma nuk janë shtruar andaj pyeti Drejtorinë e Shërbimeve Publike se kur do të bëhet rregullimi i këtyre rrugëve.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – në emër të tij, por edhe në emër të anëtarëve të kuvendit, kërkoi që të bëhet pastrimi i kanaleve të ujërave para se të fillojë stina e dimrit. Ky qëndrim i propozuar nga ana e tij u mbështet me vota unanime të anëtarëve të kuvendit. Pastaj kërkoi nga KEDS-i që të përmirësohet gjendja me energji elektrike.

Në fund kuvendi me vota unanime votoi qëndrimet e propozuara nga anëtari i kuvendit z.Muharrem Shabani.

Mbledhja përfundoi në ora 12:40.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Muharrem Shabani

Anëtar i Kuvendit

